



OSHEE GROUP sh.a njofton mbi hapjen e vendeve vakante **Shef Ekipi** pranë OSSH sh.a.

SHEF EKIPI

Përshkrimi i Punës:

Shefi i Ekipit është përgjegjës për menaxhimin e aktiviteteve teknike dhe operacionale në zonën e tij/saj, duke mbikëqyrur specialistët e fiderëve dhe siguruar përmbushjen e objektivave të kompanisë. Roli përfshin azhornimin e të dhënave të abonentëve, monitorimin e saktësisë së matjeve, zbulimin e abuzimeve dhe zbatimin e rregullave të sigurisë në furnizimin me energji.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- **Menaxhimi i Abonentëve dhe Azhornimet:**
 - Azhordon informacionin e abonentëve dhe siguron që koordinatat e tyre të jenë të sakta.
 - Përmbush detyrat përmes Sistemit të Menaxhimit të Fuqisë Punëtore dhe urdhrave të punës.
 - Siguron produktivitetin e analizave gjithëpërfshirëse dhe planifikimin e punës për specialistët e fiderëve.
- **Sistemi i Matjes:**
 - Monitoron dhe inspekton matësat dhe asetet teknike brenda zonës.
 - Garanton saktësinë e procesit të leximeve në pika matjeje për zonën e tij/saj.
 - Ndjek dhe monitoron energjinë e hyre dhe të shitur tek abonentët, duke përfshirë dhe analizën e tensionit.
- **Përmirësimi i Rezultateve:**
 - Kryen ndërprerjet efikase për abonentët debitorë.
 - Raporton aktivitetet për përmirësimin e rezultateve të kompanisë dhe përmbush objektivat në kohë.
- **Zbulimi i Abuzimeve:**
 - Identifikon dhe ndërhyr në rastet e furnizimit ilegal ose ndërhyrjeve në sistemin e matjes.
 - Ndjek procedurat për ndërprerjen dhe dokumentimin e rastit në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- **Siguria dhe Standardet Teknike:**
 - Inspekton linjat TM-TU dhe monitoron riparimet e defekteve për të siguruar furnizim të qëndrueshëm.
 - Zbaton rregullat e sigurisë dhe organizon ndërhyrjet teknike në rast emergjence.



- **Menaxhimi i Ekipit:**
 - Cakton objektivat dhe planifikon punën për specialistët e fiderit.
 - Mbikëqyr dhe mbështet specialistët në terren dhe monitoron performancën e tyre.
 - Kryen trajnime për zhvillimin e specialistëve të tij të fiderëve.
- **Të tjera Detyra:**
 - Përbush detyra të caktuara nga eprorët dhe siguron raportimin e saktë të aktivitetit ditor.

Kualifikimet dhe kërkesat:

- Diplomë në inxhinieri elektrike ose menaxhim energjie.
- Përvojë në menaxhim ekipesh dhe operacione energjitike.
- Njohuri në menaxhimin e fuqisë punëtore dhe sistemet e matjes.
- Aftësi të forta teknike dhe zgjidhje problemesh.

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.

Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.